



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I TRANSPORTIT

PLANI I INTEGRITETIT

PËR INSTITUTIN E TRANSPORTIT

2023-2025

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Institutin e Transportit:

Znj. Lilika Radovicka, Kryetar
Z. Bujar Kotri, Anëtar
Z. Shkelqim Gjevori, Anëtar
Znj. Tefta Methasani, anëtar
Z. Ardian Bedaj, Anëtar

SHKURTESA DHE AKRONIME

GPI	Grupi i Punës për Integritetin
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
SP	Sekretari i Përgjithshëm
AB	Auditi i Brendshëm
BNJ	Burime Njerëzore
PSV	Procedura Standarde Veprimi

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Rëndësia e Planit të Integritetit.....	5
1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit	5
1.2 Qasja metodologjike	6
2. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit	6
3. Plani i veprimit.....	9

1. Rëndësia e Planit të Integritetit

Qeverisja demokratike është një parim i cili përfshin qeverisjen me transparencë, llogaridhënie dhe të hapur, një parakusht ky për zhvillimin e qëndrueshëm dhe prosperitetin. Me këtë qëllim, Plani i Integritetit, kontribuon në forcimin dhe konsolidimin e administratës publike, e cila karakterizohet nga integriteti, transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve publike.

Instituti i Transportit, si institucion varësie i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është i ndërgjegjshëm për sfidat në kuptimin e integritetit dhe llogaridhënies në sistemin e vet, si dhe është angazhuar në këtë kuadër për përmirësimin dhe forcimin e parimeve të administratës publike. Prandaj, Instituti i Transportit ka zhvilluar këtë Plan të Integritetit, i cili përmban çështjet e rëndësishme për sistemin e menaxhimit të integritetit të tij.

Zhvillimi i mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies do të ndihmojnë në forcimin e llogaridhënies së Institutit të Transportit, që është parakusht thelbësor për parandalimin e korrupsionit.

Ky Plan Integriteti synon të arrijë përmirësime të rëndësishme sistematike drejt qeverisjes së mirë në Institutin e Transportit, konkretisht në:

- Përmirësimin e standardeve të aksesit në informacionin publik, i cili do të rrisë transparencën;
- Përmirësimin e akteve të brendshme rregullatore në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, duke konsoliduar një administratë që karakterizohet nga etika dhe integriteti;
- Forcimin e mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare, që do të rrisë besimin e publikut ndaj Institutit të Transportit, si edhe rritjen e nivelit të pjesëmarrjes së publikut në aktivitetet e saj aty ku është e mundur;
- Përmirësimin e mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar, e cila do të sigurojë efikasitet në menaxhimin e fondeve publike.

1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit në Institutin e Transportit

Plani i Integritetit, është rezultat i një analize gjithëpërfshirëse për identifikimin dhe vlerësimin e riskut të integritetit në Institutin e Transportit, analizë e cila u krye gjatë periudhës dhjetor 2021 – mars 2022. Procesi përfshiu vlerësimin sipas këtyre fushave të veprimtarisë së Institutit të Transportit: (i) Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm; (ii) Menaxhimi i Burimeve Njerëzore; (iii) Ruajtja dhe administrimi i

dokumenteve zyrtare; (iv) Përditësimi dhe mirëmbajtja e databazës së transportit; (v) Zhvillimi dhe zbatimi i studimeve dhe projekteve në fushën e transportit; (vi) Përditësimi i Planit Kombëtar të Transportit; (vii) Përditësimi i Modelit (TRANSCAD). Instrumenti metodologjik i përdorur është metodologjia për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore. Ai u zbatua nga grupi i punës me punonjës të Institutit të Transportit.

Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

Më qëllim zhvillimin e një Plani Integriteti, është miratuar me Urdhër të titullarit të Institutit të Transportit nr. 17/1 datë 03.08.2023 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Planit të Integritetit”, i ndryshuar, grupi i punës me 5 anëtarë. Grupi i punës komunikoi qëllimin dhe objektivat e Planit të Integritetit me titullarin e Institutit të Transportit në një sesion informues për Planin e Integritetit dhe procesin e planifikimit të tij. Ky sesion i mbajtur që në fillim të procesit të zhvillimit të Planit të Integritetit, ndihmoi grupin e punës për të marrë në konsideratë një larmi çështjesh në institucion.

Faza 2: Identifikimi dhe analizimi i risqeve të integritetit

Grupi i punës shqyrtoi kornizën ligjore, rregullatore, strategjike, si dhe dokumente të ndryshme operative të Institutit të Transportit. Gjithashtu, u analizuan të dhëna nga performanca, monitorimi dhe zbatimi i aspekteve të veçanta të integritetit në institucion. Grupi i punës, vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë së institucionit.

Faza 3: Plani i masave për menaxhimin e integritetit dhe miratimi

Në kuadër të konsolidimit të një sistemi të menaxhimit të integritetit në institucion, Instituti i Transportit disponon mekanizma për sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit. Për këtë arsye, grupi i punës, hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit, i cili përfshin masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Analiza e realizuar në fazën e mësipërme diktoi nevojën për të përmirësuar kuadrin rregullator të brendshëm dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, përmes forcimit të njësisë së sinjalizuesve, konfliktit të interesit, etikës, aksesit në informacionin publik dhe konsultimin publik. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

1.2 Metodologjia

Grupi i punës, në procesin e zhvillimit të Planit të Integritetit, ka zbatuar metodën cilësore për të analizuar dhe vlerësuar cënueshmërinë e integritetit. Është zhvilluar një sesion trajnues me grupin e punës dhe punonjësit e Institutit të Transportit për metodologjinë e vlerësimit të

integritetit për institucionet publike. Këtu përfshihet edhe analiza e kuadrit të brendshëm rregullator të Institutit të Transportit, e cila përfshin, urdhra, manuale, dokumente politikash, rregullore dhe akte të brendshme. Gjithashtu, u hulumtuan raporte të ndryshme mbi veprimtarinë e Institutit të Transportit, të hartuara nga entitete kombëtare, ndërkombëtare dhe organizata të ndryshme. Në vijim, është kryer analizimi i të dhënave nga grupet e diskutimit me stafin. Takimet e fokusuara shërbyen për të identifikuar ngjarje me risk të mundshëm në realizimin e proceseve të punës, praktika pune dhe funksione të cilat janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të mundshme etike dhe profesionale, apo parregullsi të tjera.

2. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit

Qëllimi kryesor i këtij Plani të Integritetit, është përmirësimi i sistemit të llogaridhënies, integritetit dhe transparencës në Institutin e Transportit, për të rritur besimin publik ndaj tij, si edhe për përmirësimin e mekanizmave kundër korrupsionit. Për arritjen e synimeve të mësipërme u identifikuan pesë objektiva:

- Përmirësimi i mekanizmave të etikës dhe integritetit;
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare;
- Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Përmirësimin e drejtimit të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin.

Objektivat

2.1 Përmirësimi i etikës dhe mekanizmave të integritetit në Institutin e Transportit

Me qëllim përmirësimin dhe forcimin e mekanizmave të etikës dhe integritetit, Instituti i Transportit do të punojë në:

- Përmirësimin e akteve të brendshme për aspekte të veçanta të lidhura me etikën dhe integritetin;
- Zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, bazuar në parimet e etikës dhe integritetit.

Respektimi rigoroz i normave etike nga punonjësit e administratës së Institutit të Transportit, është i rëndësishëm për krijimin e një mjedisi pune që parandalon sjelljen jo-etike dhe joprofesionale. Instituti i Transportit do të vijojë të përmirësojë rregulloret dhe informojë punonjësit, me qëllim respektimin e normave të etikës dhe integritetit, të parashikuara nga legjislacioni për etikën në administratën publike në fuqi.

Rregulloret e brendshme të rishikuara të Institutit të Transportit do të mbulojnë komunikimin zyrtar, paanshmërinë, disiplinën e punës dhe menaxhim efikas të burimeve publike. Instituti i Transportit do të sigurojë që të respektohen parimet e etikës nga ana e saj, në mënyrë që mekanizmat e menaxhimit të tyre të jenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor, përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe Kodin e Etikës së institucionit.

Në arritjen e këtij objekti, Instituti i Transportit do të zbatojë dy drejtime kryesore për parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo-etike të lidhura me integritetin:

Së pari, Instituti i Transportit do të punojë në drejtim të forcimit të mekanizmave institucionalë, me qëllim minimizimin e risqeve të shkaktuara nga humbja e personelit të kualifikuar dhe ndryshimi i menaxhimit ose legjislacionit.

Së dyti, do të fokusohet në ndërgjegjësimin e punonjësve, ku përpos rritjes së kapaciteteve të stafit aktual të Institutit të Transportit, do të trajnojnë punonjësit e punësuar rishtazi mbi rregulloret që lidhen me etikën, integritetin dhe konfliktin e interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Promovimi i mbrojtjes së sinjalizuesve është thelbësor për një administratë publike cilësore, të paanshme, efektive, që bazohet në parimet e integritetit dhe objektivitetit. Mbrojtja e sinjalizuesve është gjithashtu e rëndësishme si një mekanizëm efektiv i mbikëqyrjes publike. Instituti i Transportit do të ndërgjegjësojë dhe informojë në mënyrë periodike punonjësit e saj mbi procedurat ligjore në lidhje me sinjalizuesin dhe mbrojtjen e tij, në mënyrë që sinjalizuesit ta kenë më të lehtë raportimin ligjor, shkeljet dhe sjelljet e tjera jo-etike.

2.2 Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, Instituti i Transportit angazhohet të vazhdojë të zbatojë me rigorozitet ligjin për shërbimin civil, i cili garanton një kuadër të sigurtë ligjor për krijimin e një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm. Përveç kësaj, do të bëhen përpjekje për të forcuar një politikë të menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila do të bazohet në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritave, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton stabilitetin e nëpunësve civilë dhe vazhdimësinë e shërbimit civil.

Për këtë arsye, Instituti i Transportit do të vijojë të punojë drejt garantimit të një administrate të qëndrueshme dhe parandalimit të humbjes së personelit të kualifikuar, e cila synon të rrisë efikasitetin dhe do të forcojë mundësitë për zhvillim profesional.

2.3 Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare

Me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe integritetit, Instituti i Transportit do të punojë drejt përmirësimit të mekanizmave të transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare, i cili do të rrisë besimin e publikut ndaj institucionit dhe do të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore publike.

Duke konsideruar rëndësinë e aksesit në informacionin publik për krijimin e një administrate transparente, Instituti i Transportit do të vijojë të punojë në drejtim të metodave proaktive në publikimin e informacionit publik.

Instituti i Transportit do të vijojë të mbështesë përgatitjen e informacionit publik në formate të dhënash të hapura, të cilat do të thjeshtonin përdorimin, analizën dhe përhapjen e tij. Instituti i Transportit do të përmirësojë edhe mekanizmat për informimin e qytetarëve për aktivitetet e planifikuara dhe të përfunduara të saj.

Mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare do të përmirësohen në Institutin e Transportit nëpërmjet bashkëpunimit me ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare, shoqata biznesi, me qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes së tyre në fusha të ndryshme të saj.

2.4 Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit Financiar, Monitorimit dhe Kontrollit të Brendshëm.

Një komponent i rëndësishëm i qeverisjes së mirë në Institutin e Transportit, është edhe promovimi i planifikimit racional dhe monitorimi efektiv i aktiviteteve të saj, përfshi këtu programe dhe projekte në planifikim transporti.

Duke qenë se përditësimi i Planit Kombëtar të Transportit, mirëmbajtja dhe azhurnimi i databazës së transportit dhe projektet e studimet e ndryshme në fushën e transportit, përbëjnë shumicën e aktiviteteve të Institutit të Transportit, Instituti i Transportit angazhohet në hartimin dhe zbatimin e metodologjive të monitorimit, të cilat do të kontribuojnë edhe në përmirësimin e këtij plani dhe monitorimit të projekteve të ndryshme.

2.5 Përmirësimi i drejtimeve dhe ndërhyrjeve të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin në fushat e përgjegjësisë së Ministrisë.

Një objektivi i rëndësishëm i këtij plani është edhe përmirësimi i drejtimeve të politikave në fushat e veprimtarisë së Institutit i Transportit të tilla si: përditësimi i Planit Kombëtar të Transportit, mirëmbajtja dhe azhurnimi i databazës së transportit dhe projektet e studimet e ndryshme në fushën e transportit si edhe përforcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm në këto sektorë.

Instituti i Transportit është i vetëdijshëm se ky dokument është një ndër instrumentet që demonstrojnë vullnetin dhe angazhimin e tij për të ngritur nivelin e integritetit institucional dhe mundësuar politika efikase në fushat e sipërpërmendura të aktiviteteve të tij, transparencë dhe gjithpërfshirje dhe përgjatë hartimit, zbatimit dhe monitorimit të tyre.


3 Plani i Veprimit

Plani i Veprimit, përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit, të identifikuara sipas fushave të përgjegjësisë së Institutit të Transportit. Ai përmban përshkrime për aktivitetet specifike që do të zbatohen për të arritur gjashtë objektivat e Planit të Integritetit. Zbatimi i Planit të Integritetit, do të pasohet nga procesi i raportimit dhe monitorimit.

Raportimi është një procedurë e rregullt, që siguron zbatimin e Planit të Integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është përgjegjës për të ndjekur progresin e zbatimit. Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe gjashtëmujore.

Monitorimi i Planit të Integritetit është periodik (çdo vit) dhe pasqyron kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në të. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikase, nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e tij. Pas monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit, Instituti i Transportit do të rishikojë dokumentin dhe do ta përditësojë atë me sfidat e ardhshme. Instituti i Transportit do të publikojë gjithashtu një raport për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.

Fig. 1. *Monitorimi i Planit të Veprimit*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I TRANSPORTIT

PLANI I VEPRIMIT

PËR MENAXHIMIN E RISQEVË TË INTEGRITETIT

PËR INSTITUTIN E TRANSPORTIT

2023-2025

OBJEKTIVI 1: PËRMIRËSIMI I ETIKËS DHE MEKANIZMAVE TË INTEGRITETIT NË INSTITUTIN E TRANSPORTIT

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
1	Njohuri të pamjaftueshme për etiken, konfliktin e interesave, mos diskriminimin, te punonjësve të përfshirë ne hartimin dhe monitorimin e zbatimit te kontratave publike	Burimet Njerëzore/ Reputacional dhe Imazhi	Mesatar	Ofrimi i trajnimeve për etiken, konfliktin e interesave, mos diskriminimin, të punonjësve të përfshirë ne procesin e hartimit dhe monitorimit të zbatimit të kontratave publike.	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse (ASPA) (6-mujori i II-të 2023 dhe në vazhdim)
2	Mungesë informacioni për publikun mbi mekanizmat kontrollues dhe monitorues në Institutin e Transportit.	Operacional	Mesatar	Zbatim i detyrimit ligjor, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale, për të bërë transparente mekanizmat kontrollues dhe monitorues në Institutin e Transportit, nëpërmjet publikimit të raporteve të Auditit dhe KLSH tek seksioni përkatës i Programit të Transparencës.	Koordinatori për të drejtën për informim (6-mujori i II-të 2023 dhe në vazhdim)

3	Njohuri të pamjaftueshme për etiken, konfliktin e interesave, mosdiskriminim, te punonjësve te perfshire ne hartimin dhe monitorimin e zbatimit te kontratave publike	Burimet Njerëzore/ Reputacional dhe Imazhi	Mesatar	Ofrimi i trajnimeve për etiken, konfliktin e interesave, mosdiskriminim, te punonjesve te perfshire ne procesin e hartimit dhe monitorimit të zbatimit te kontratave publike.	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse (ASPA) (6-mujori i II-të 2023 dhe në vazhdim)
---	---	--	---------	---	---

OBJEKTIVI 2: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Fusha e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve

4	1. Mosrakordimi me ASPA për trajnimin e stafit të Institutit të Transportit në fushat e përgjithshme. 2. Mungesë e një analize mbi nevojat dhe e një plani trajnimesh për rritjen profesionale të stafit për detyra specifike/teknike të Institutit të Transportit.	Operacional	Mesatar	1. Vlerësimi i nevojave për trainim dhe hartimi i një plani trainimi për stafin e Institutit në bashkëpunim me ASPA. 2. Hartim dhe zbatim i procedurave për transferimin e njohurive dhe shpërndarjen e materiale trainuese nga personat e trainuar punonjësve të tjerë që kanë interes në mënyrë që të sigurohet një përfitim maksimal.	BNJ në bashkëpunim me strukturat e MIE (6-mujori i I-rë 2023 dhe në vazhdim)
5	Vështirësi në procesin e përgatitjes së materialeve të mbledhjeve për shqyrtim nga analiza vjetore, shpërndarja, si dhe riformulimi i tyre mbi bazën e vërejtjeve të bëra në mbledhje.	Operacional	Mesatar	1. Sekretaria përgatit materialet për shqyrtim në analizen vjetore, sistemimi, shtypja, shumëfishimi, shpërndarja dhe riformulimi i tyre mbi bazën e vendimeve të dala nga mbledhja vjetore 2. Informimi i të gjithë sektoreve.	Drejtoria e Institutit të Transportit (3-mujori i I-rë 2024)
6	Zevendesimi i punonjësve (largime apo dalje ne pension) dhe mungesa e një procesi transparent për ruajtjen e profesioneve brenda fushes së aktivitetit të Institucionit.	Burimet Njerëzore/ Operacional	Mesatar	1. Marrja e mendimit tek Sektori perkates dhe rekrutimi sipas kriterëve të vendosura nga sektoret për punonjësit që do rekrutohen rishtazi. 2. Ky detyrim të rregullohet në nivel të cdo Sektori.	Drejtoria Sektoret e Institutit (6-mujori i II-të 2023 dhe në vazhdim)

OBJEKTIVI 3: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE

Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronike

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
7	Mungesa e kushteve optimale të ruajtjes së informacionit që mund të sjellë humbje/dëmtim të tij.	Operacional	Mesatar	Vlerësimi i mundësisë për përmirësimin e kushteve teknike të ambienteve të arkivës. Risistemim të dokumenteve arkivore të mbartura.	Grup pune (6-mujori i II-të 2023 dhe në vazhdim)
8	Mungesa e punonjësit të IT-së, duke e bërë të vështirë dhe vijimin e detyrës së punonjësve.	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse	Mesatar	Koordinim me AKSHI-n	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse +AKSHI (6-mujori i II-të 2023 dhe vazhdim)
9	Mospërshtatshmëria e sistemeve ekzistuese të IT-së për shkak të kapaciteteve të ulëta të ruajtjes së informacionit.	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse / Operacional	Mesatar	Marrja e masave për ngritjen e kapaciteteve storage të sistemeve IT, në përputhje me analizën e volumit të punës në Institutin e Transportit.	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse + IT (6-mujori i II-të i 2023)
10	Mangësi në pajisjet e nevojshme, si kompjutera, printera, skanera, për përpunimin, dokumentimin dhe ngarkimin e dokumentacionit në sistemin elektronik.	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse/ Operacional	Mesatar	Marrja e masave, mbi bazën e analizës së volumit të punës, për sigurimin e pajisjeve të nevojshme si skanera, për ngarkimin me eficientë të dokumentacionit në sistemin elektronik.	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse + IT (6-mujori i II-të i 2023)

11	Pamundësi e identifikimit dhe përpunimit në kohë të dokumentacionit të trashëguar	Operacional	Mesatar	Rivlerësim i mundësisë për risistemim të dokumenteve arkivore të mbartura.	Grup Pune (6-mujori i II-të 2024)
12	Mungesa e realizimit të procedurës së back-up-it nga IT/sistem i përgjithshëm, duke e bërë të vështirë pajisjen me dokumentacionin elektronik	Teknologjia e Informacionit/Operacional	Mesatar	Zbatimi i procedurës për realizimin e back-up, në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe vënia në dispozicion e dokumentacionit elektronik, punonjësve të emëruar rishtazi.	Sektori i Sherbimeve Mbeshtetese (6-mujori i I-rë 2023)
13	Mungesa e të dhenave ne format elektronik/shkresor, mund të sjellë vështirësi dhe pamundësi në kryerjen e detyrave funksionale.	Teknologjia e Informacionit/Operacional	Mesatar	Koordinim me Institucionet me te cilat ekzistojnë marreveshje	Sektori i Databazës (6-mujori i II-të 2023 dhe vazhdim)
14	Vonesa ne marrjen e te dhenave, apo marrja e tyre e cunguar ne format elektronik/shkresor, mund të sjellë vështirësi dhe pamundësi në kryerjen e detyrave funksionale.	Teknologjia e Informacionit/Operacional	Mesatar	Koordinim me Institucionet me te cilat ekzistojnë marreveshje	Sektori i Databazës (6-mujori i II-të 2023 dhe vazhdim)
15	Veshtiresi te karakterit buxhetor per trajnimin e vazhdueshem te stafit	Operacional	Mesatar	Ofrimi i trajnimeve ne vazhdimesi	Sektori i Sherbimeve Mbeshtetese (6-mujori i II-të 2023 dhe vazhdim)

OBJEKTIVI 4: POLITIKA DHE ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS SË TRANSPORTIT

Fusha e Programeve të Zhvillimit të Studimeve dhe Projekteve të Transportit					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut / Tipi i impaktit)	Rreziku Inheren t	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
16	Përditësimi i të Dhënave Social Ekonomike në kuadër të Përditësimit të Planit Kombëtar të Transportit. Mos-disponibiliteti i të dhënave zyrtare nga INSTAT në kohën e nevojshme për të kryer Përditësimin e Planit Kombëtar të Transportit.	Operacional	Mesatar	Merren të dhëna të azhornuara nga INSTAT (nga publikimet e INSTAT online apo edhe duke j'u drejtuar me email/shkresë) për të dhënat social-ekonomike të vitit të fundit dhe paraqiten në mënyrë tabelore/grafike.	Spektori i Planifikimit të Transportit (6- muji i I-rë 2023)
17	Përditësimi i të dhënave të prodhimit të mallrave. Mos-disponibiliteti i të dhënave zyrtare nga INSTAT në kohën e nevojshme për të kryer Përditësimin e Planit Kombëtar të Transportit.	Operacional	Mesatar	Merren të dhëna të azhornuara nga INSTAT (nga publikimet e INSTAT online apo edhe duke j'u drejtuar me email/shkresë) për të dhënat e prodhimit të mallrave të vitit të fundit dhe paraqiten në mënyrë tabelore/grafike.	Spektori i Planifikimit të Transportit (6- muji i II-të 2023)
18	Përditësimi i të dhënave të import-eksportit të mallrave	Operacional	Mesatar	Merren të dhëna të azhornuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të dhënat e import-eksportit të mallrave të vitit të fundit dhe paraqiten në mënyrë tabelore/grafike.	Spektori i Planifikimit të Transportit (6- muji i II-të

					2023)
19	Përditësimi i të dhënave të hyrje-daljeve të pasagjerëve dhe mallrave në pikat kufitare	Operacional	I Ulët	Merren të dhëna të azhurnuara nga Sektori i Databazës së Transportit të Institutit të Transportit mbi hyrje-daljet e pasagjerëve dhe mallrave gjatë vitit të fundit dhe paraqiten në mënyrë tabelore/grafike.	Sektori i Planifikimit të Transportit (6- mujori i II-të 2023)
20	Përditësimi i Modelit të transportit të mallrave dhe pasagjerëve	Operacional	I Ulët	Mbi bazën e të dhënave të marra nga Sektori i Databazës së Transportit mbi hyrje-daljet e pasagjerëve dhe mallrave gjatë vitit të fundit, bëhet analiza e tyre dhe matrica e flukseve të transportit të pasagjerëve dhe mallrave. Paraqiten në menyre tabelore dhe grafike.	Sektori i Planifikimit të Transportit (6- mujori i II-të 2023)
21	Mungesë e një analize mbi nevojat dhe e një plani trajnimesh për rritjen profesionale të stafit për detyra specifike/teknike të tyre.	Operacional	Mesatar	1. Vlerësimi i nevojave për trainim dhe hartimi i një plani trainimi për stafin e Sektorit të Planifikimit të Transportit në bashkëpunim me ASPA. 2. Hartim dhe zbatim i procedurave për transferimin e njohurive dhe shpërndarjen e materiale trainuese nga personat e trainuar punonjësve të tjerë që kanë interes në mënyrë që të sigurohet një përfitim maksimal.	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim Sektorin e Planifikimit të Transportit(Viti 2023)

22	Mungesa e një baze të dhënash në format elektronik në nivel Sektorit që përmban informacion për të gjitha studimet dhe projektet ne fushen e transportit pavarësisht formës së financimit.	Teknologjia e Informacionit/ Operacional	Mesatar	1. Krijimi i një baze të dhënash në format elektronik me infomacion të detajuar për të gjitha studimet dhe projektet ne transport, pavarësisht financimit. 2. Përditësimi i kësaj baze të dhënash nga punonjësit e Sektorit 3. Krijimi i një liste kontrolli që do mundësojë plotësinë e informacionit të përditësuar.	Sektori i Studimeve dhe Projekteve (6-mujori i II-të 2023)
23	Mungesa e një analize vjetore për realizimin e Studimeve dhe Projekteve ne fushen e Transportit përfshi edhe ato me financim të huaj, për problematikat dhe çështje të tjera.	Operacional	Mesatar	1. Kryerja e një analize vjetore, nga Drejtoria e Institutit te Transportit, për realizimin e Studimeve dhe Projekteve ne transport, problematikat dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin. 2. Analiza i paraqitet titullarit të Ministrisë dhe Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Transportit. 3. Përcaktimi i këtij detyrimi në Rregulloren e Brendshme të Institutit te Tranporit.	Drejtorja e Institutit te Transportit (3-mujori i I-rë 2024)
24	Veshtiresi ne realizimin e Kursit te Auditimit/Inspektimit te Sigurise Rrugore.	Operacional	I Larte	Krijimi i faciliteteve për zhvillimin e Kursit, pajisjet IT dhe logjistika te tjera.	Sektori i Sherbimeve Mbeshtetese (Vazhdimisht)
25	Mungesë buxheti per pagese te trainuesve për procesin e organizimit të Kurseve te Auditim/Inspektimit te Sigurise Rrugore.	Operacional	I Larte	Përfshirja në buxhetin e Institutit të nevojave për kryerjen e Kurseve te Auditim/Inspektim te Sigurise rrugore.	Sektori i Sherbimeve Mbeshtetese (6-mujori i I-rë 2024)
26	Njohuri të kufizuara të punonjësve të Sektorit te Studimeve dhe Projekteve per Konceptimin dhe realizimin e Fizibilitetit të Projekteve të Transportit.	Burimet Njerëzore/ Operacional	Mesatar	Ofrimi i trajnimeve për rritjen e nivelit teknik.	Sektori i Sherbimeve Mbeshtetese (6-mujori i II-të 2024)

27	Njohuri të kufizuara të punonjësve të Sektorit të Studimeve dhe Projekteve për kryerjen e procesit të prokurimit sipas PRAG Rules.	Burimet Njerëzore/ Operacional	Mesatar	Ofrimi i trajnimeve për programet e reja të fondeve për proceset të prokurimit sipas PRAG Rules.	Sektori i Shërbimeve Mbeshtetëse (6-mujori i dytë 2024)
28	Njohuri të kufizuara të punonjësve të Sektorit të Studimeve dhe Projekteve për aplikime në programet e reja për fondet IPA.	Burimet Njerëzore/ Operacional	Mesatar	Ofrimi i trajnimeve për programet e reja për aplikime në fondet IPA.	Sektori i Shërbimeve Mbeshtetëse (6-mujori i II-të 2024)
29	Vonesa në realizimin e Studimeve dhe Projekteve si rrjedhojë e koordinimit të kufizuar ndërsektorial dhe ndërinstitucional mes Sektoreve të Institutit dhe strukturave të Ministrisë për vonesat apo mos aprovimet e takimeve me partneret e Projekteve të huaja.	Operacional	Mesatar	1. Rritja e bashkëpunimeve sektoriale dhe ndërinstitucionale. 2. Rritja e bashkëpunimit me strukturat e Ministrisë për aprovimin e takimeve me partneret e huaj.	Drejtoria e Institutit të Transportit. Sektori i Shërbimeve Mbeshtetëse Ministria (Drejtoria BNj)
30	Vështirësi për realizimin e aktiviteteve të nevojshme në shërbim të Studimeve dhe Projekteve të mbikëqyrjes/monitorimit në aspektin teknik, logjistik dhe atë të cilësisë për shkak të mungesës së mjetit të transportit	Burimet Njerëzore/ Operacional	Mesatar	Mundësimi për efikasitetin dhe performancën për realizimin e Studimeve dhe Projekteve..	Sektori i Shërbimeve Mbeshtetëse (6-mujori i II-të)

				2023)
--	--	--	--	-------

OBJEKTIVI 5: RRRITJA E TRANSPARENCËS DHE PJESËMARRJES QYTETARE

Fusha e transparencës dhe llogaridhënies					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
31	1. Mungesa e aktit për ngarkimin e detyrave shtesë, si ajo e koordinatorit për të drejtën e informimit, që mund të sjellë riskun e pamundësisë ligjore për kërkim llogarie ndaj/mbajtje përgjegjësie prej punonjësit përkatës. 2. Mungesa e përcaktimit të detyrave të koordinatorit për të drejtën e informimit në Rregulloren e Brendshme apo akte të tjera.	Operacional/ Reputacioni dhe Imazhi	Mesatar	1. Të miratohet me Urdhër Titullari koordinatori për të drejtën e informimit si një detyrë shtesë, përkrah atyre funksionale. 2. Caktimi i koordinatorit të bëhet duke vlerësuar ngarkesën mes detyrës shtesë dhe detyrës funksionale/ose detyra shtesë të realizohet me rrotacion për të mos mbingarkuar gjatë një person. 3. Të përfshihen detyrat e koordinatorit për të drejtën e informimit në Rregulloren e Brendshme ose aktin e posaçëm.	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse (6-mujori i II-të 2023 për aktin/detyrat në Rregullore në afatin e rishikimit të saj)

32	1. Mangësi mbi transparencën e mekanizmave kontrollues dhe monitorues mbi Institutin e Transportit, të cilat garantojnë monitorimin nga publiku. 2. Paaksesueshmëri e informacionit në PT, si pasojë e çështjeve teknike në ëeb.	Operacional/ Reputacioni dhe Imazhi	Mesatar	1. Të plotësohet programi i transparencës me dokumentacionin që duhet dhënë pa kërkesë, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”. 2. Të zgjidhen problemet teknike të ëeb-sitit të institutit të Transportit, në mënyrë që informacioni i hedhur tek programi i transparencës të bëhet i aksesueshëm. 3. Hartimi i një liste kontrolli mbi plotësinë e publikimeve në faqen e web-it.	Koordinatori+ IT (Gjashtëmujori i dytë 2023 e në vijim)
33	1. Draft-aktet e shumta për konsultim publik mbingarkojnë koordinatoren për njoftim dhe konsultim publik, duke cënuar cilësinë e detyrës specifike dhe atyre funksionale. 2. Mungon përcaktimi i detyrave të koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik në Rregulloren e Brendshme apo akt të veçantë.	Operacional	Mesatar	1. Të vlerësohet nga Instituti i Transportit mundësia e ngritjes me akt të Titullarit të një koordinatori të Koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. 2. Të përfshihen detyrat e koordinorit në Rregulloren e Brendshme të Institucionit apo aktin e veçantë.	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse (6-mujori i II-të 2023 për aktin/detyrat në Rregullore në afatin e rishikimit të saj)

OBJEKTIVI 6: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR, MONITORIMIT DHE KONTROLLIT TË BRENDSHËM

1. Fusha e Menaxhimit Financiar

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve
34	Mosparashikimi i sakte dhe në kohë i nevojave dhe kërkesave në nivel programesh për hartimin e PBA-së.	Operacional	Mesatar	Miratimi i programit shtese ne nivel anëtarësh te ekipeve te programeve buxhetore mbi procedurat dhe afatet standarde per përgatitjen e programeve buxhetore.	Grup Pune (6-mujori i II-të 2023 e çdo vit buxhetor)
35	1. Mungesa apo parregullsi në dokumentet justifikuese dhe vërtetuese, bashkëlidhur praktikave të likuidimit. 2. Mosrespektimi i afateve për dorëzimin e praktikave, për likuidimin e faturave dhe kryerjen e pagesave në kohë.	Operacional/ Financiar	Mesatar	Të evidentohen procedurat me afatet, si dhe dokumentacioni tip i nevojshëm justifikues/vërtetues për praktikat likuiduese.	Financa + Prokurimet +BNJ (6-mujori i II-të 2023)
36	1. Mungesa e dokumentacionit të detajuar për rregullat e ruajtjes, mbrojtjes, dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve. 2. Mungesa e vlerësimit të mundësisë të riciklimit të aktiveve dhe gjenerimit të të ardhurave prej tyre pas nxjerrjes jashtë përdorimit.	Operacional/ Financiar	Mesatar	1. Hartim i dokumentacionit të detajuar në përputhje me detyrimet e kuadrit rregullator për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të institutit të Transportit. 2. Sugjerohet riciklimi si një opsion më i mirë mjedisor dhe që gjeneron të ardhura pas vlerësimit të aktivëve jashtë përdorimit, ku është e aplikueshme.	Grup Pune + Sektori i Shërbimeve Mbështetëse (6-mujori i II-të 2023)

37	Mungesë burimesh njerëzore të kualifikuara në strukturat e nëpunësit zbatues për përmbushjen e funksionit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.	Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	Trajtimi financiar në pagë për Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse të jetë i kategorisë III/3 për përgjegjësin e sektorit dhe IV/2 për specialistët. Plotësimi i strukturës si dhe analiza e nevojës për trajnimin e tyre me risitë ligjore apo të sistemeve informatike.	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse / DAP (6-mujori i II-të 2023)
38	Specifikime teknike që mund të çenojnë parimin e barazisë dhe të rrisin ankimet ndaj autoritetit kontraktor.	Operacional	Mesatar	2. Hartim i një kalendari për dërgimin e projekteve dhe specifikimeve teknike për realizimin e prokurimeve sipas parashikimit.	Nëpunësi Autorizues+Prokurimet + Buxheti (6-mujori i II-të 2023)
39	1. Për shkak të risive ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimit publik ka ende paqartësi për zbatimin e ligjit nga punonjësit e ngarkuar. 2. Mosdorëzimi brenda afateve ligjore në strukturat e nëpunësit zbatues i UP dhe kontratave të angazhimit.	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	1. Bashkëpunim me ASPA/APP për zhvillim të trajnimeve specifike mbi legjislacionin dhe procedurat e reja të prokurimit publik për stafin e ngarkuar me realizimin e procedurave të prokurimeve. 2. Të përcaktohet procedura me afate të qarta dhe me dokumentacionin e nevojshëm për strukturat e nëpunësit zbatues.	Grup Pune Nëpunësi Autorizues Prokurimet + Shërbimet Mbështetëse (6-mujori i I-rë 2023)

Fusha e kontrollit, auditimit dhe mekanizmave kundër korrupsionit					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati I fundit për zbatimin e aktiviteteve

40	Mungesë e gjurmës së auditimit të detajuar për procedurat kryesore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Operacional	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i gjurmëve të auditimit, të detajuara për procedurat kryesore, të cilat të sigurojnë që të gjitha operacionet të dokumentohen sipas kuadrit të standardeve të audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të mjedisit të kontrollit.	Grup Pune (6-mujori i II-të 2023)
----	---	-------------	---------	--	--------------------------------------